

HAJRI SHEHU

FJALA SI NJËSI E MËVETËSISHME E FJALËSIT

Çfarë është *fjala*? Koncept i madh e i vështirë. Koncept i rrahur në tërë historinë e gjuhësisë (që nga Aristoteli). Dhe të leksikografisë. Nga arabët, në shekullin VII. Nga nevoja për të shpjeguar e komentuar Kur'anin. Në Babiloni, shumë më herët. Në Europë, në shekullin XIII përdoret për së pari fjala *dictionarius* – vepra që merret me fjalët. Në historinë e leksikografisë sonë, më 1635. Dhe ç'është *fjala*? *Fjala* është njësi e mëvetësishme më e vogël e gjuhës, që përbëhet nga disa tinguj a nga një tingull, e formësuar gramatikisht, që shënon sende e dukuri të realitetit ose shpreh qëndrimin e folësit ndaj asaj që thotë, lidh gjymtyrë të një fjalie ose fjali dhe riprodhohet e veçohet në rrjedhën e ligjërimit.” (*Fjalor i gjuhës shqipe*, 2006). Gjuhësisht, ky është koncepti për fjalën.

Po cili është koncepti *leksikografik* për fjalën? Sigurisht, ai ndjek konceptin gjuhësor për të. Edhe leksikografikisht, ajo është “njësia e mëvetësishme më e vogël e gjuhës ..., e formësuar gramatikisht, që shënon sende e dukuri të realitetit ose shpreh qëndrimin e folësit ndaj asaj që thotë ...”. Por, në këtë konceptualizëm – *fjala si njësi e mëvetësishme e fjalësit të një fjalori* – duam të përveçojmë disa koncepte:

1. Siç dihet, në çdo gjuhë ka më pak fjalë se nocione. Sikur të gjitha nocionet e përpunuara nga një popull, të kishin nga një veshje tingullore, leksiku i gjuhës do të ishte kaq i madh, sa njohja e tij do të ishte e pamundur nga pjesëtarët e bashkësisë ligjërimore, për të mos thënë që komunikimi mund të bëhej i vështirë. Mrekullia e gjuhëve është shumëkuptimësia (e cila është njëherësh edhe ekonomi gjuhe), pra, mundësia e fjalës për të shërbyer si veshje tingullore për disa a për shumë nocione. (Sigurisht, te fjala, në çdo akt të komunikimit gjuhësor, nocioni a koncepti mund të saktësohet edhe me ndihmën e mjeteve të tjera gjuhësore – morfologjike, sintaksore etj.). Këtë mrekulli e ka edhe gjuha shqipe. Atëherë, pasuria e leksikut të gjuhës shqipe dhe e **fjalorit të saj** nuk mund të shihet vetëm te numri i përgjithshëm i fjalëve dhe nuk mund të përcaktohet vetëm me numrin e përgjithshëm të fjalëve, por edhe te, *edhe me kuptimet e tyre¹ e ngjyresat e tyre kuptimore.²* Fjalori

¹ Shih, p.sh., *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe* (1980). Ai është i tipit të mesëm në punë të leksikut aktiv e të shtresës pasive të fjalëve. Por ai ka mbi 180 000 kuptime leksikore, çka do të thotë se në punë të semantikës leksikore i kapërcen kufijtë e tipit të mesëm. Jani Thomai, *Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë*, në

sistematizon kuptimet e fjalëve. Në këtë sistematizim është koncepti njësi leksikore. Në këtë sistematizim, fjalori përdallon kuptimet e kryehershme, kuptimet e reja të fjalëve të vjetra, poliseminë nga homonimia etj. Të gjitha këto përdallime janë çështje *fjale* - me karakteristikat përkatëse gramatikore e stilistikore.

2. Njeriut i duhet të flasë për çdo gjë të re që i paraqit natyra, jeta e puna. Kjo do të thotë që shumësia e leksikut është e pafund. Fjalëformimi është një nga mekanizmat gjuhësorë më të rëndësishëm që e siguron këtë shumësi të leksikut. Edhe pafundësinë e leksikut. Veçse nuk e siguron “pafundësinë” e leksikut në atë shkallë, në të cilën gramatika siguron pafundësinë e frazave (ndërtimin e pafund të frazave). Përse? Sepse fjalëformimi ka kufizime të ndryshme. Fjalëformimi e krijon potencialisht mundësinë për pafundësi të leksikut, por kjo mundësi kurrë nuk mund të realizohet. Kjo varet, sigurisht, edhe nga tradita gjuhësore e bashkësisë ligjërimore. Shih, p.sh., deri ku shkon pafundësia dhe mundësia të foljet më **-(ë)zo:j** (tipi **pyllëzoj / fushëzoj?**; **korijëzoj?/...**), ose të fjalët e përbëra pronësore (tipi **zemërluan / zemërtigër? / zemërdele? ...**). Atëherë, **është fjalori** ai, që na i tregon *fjalën dhe fjalët*, mundësinë dhe pamundësinë. Në fjalë dhe në fjalor “lexohen” proceset sinkronike të fjalëformimit: struktura e fjalës – tema, rrënja, ndajshitesat etj. Në disa fjalorë, edhe me mënyrën e shkrimit morfologjiko-fjalëformues. Për atë që di më shumë, fjalori i tregon si formohen fjalët e reja në gjuhë, si përplotësohet leksiku i gjuhës standarde (shih, p.sh., në “Fjalorin e gjuhës shqipe” mijëra paronimet e tij). I flet edhe për një ligjërime të izoluar, i cili është ai me fjalë të huaja të panevojshme (Fjalori nuk i pasqyron të tilla njësi) a me *kalke*, që nuk janë formuar sipas modeleve normative të shqipes e nuk e japin të saktë nocionin a konceptin (edhe këto nuk i pasqyron Fjalori). I flet edhe për zgjedhjen e mjetit fjalëformues për shprehësi emocionale-stilistike (kemi parasysh prapashtesat me kuptim fjalëformues përkëdhelës, përçmues etj., pjesët e dyta të kompozitave pronësore etj.).

3. Siç dihet, ka një variacion brendagjuhësor. Është ai për të folme të caktuara brenda gjuhës kombëtare ose për periudha të caktuara kohore të zhvillimit të gjuhës kombëtare. Ka, sidomos, një variacion ndërgjuhësor (kemi parasysh sende, institucione e koncepte / p.sh., kulturore unike, të veçanta për aksh shoqëri). Pas të gjitha këtyre qëndrojnë **fjalët**. Dhe, a janë të pranueshëm në fjalorë variacioni brendagjuhësor dhe variacioni ndërgjuhësor? Variacioni brendagjuhësor leksikor është i pranueshëm për arsye gjuhësore e historike që dihen (kemi parasysh, p.sh., fjalë popullore nga të folmet krahinore të shqipes,

“Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005, f. 15. (Perifrazimi im – H.Sh.).

² Ngjyresat kuptimore të fjalëve ekzistojnë objektivist, ashtu si kuptimet. Kësisoj, mospasqyrimi i tyre në fjalor do të ishte agnosticizëm leksikografik.

me prejardhje të ndryshme leksiko-fjalëformuese ose me ngjyresa kuptimore e stilistike e kështu, mund të vijjnë si sinonime letrare potenciale për ato të gjuhës standarde / *dynak* për *binjak*, *parator* për *prijës*, *lërpardhë* për *daulinë*, *kalashtoj* për *përkëdhel*, *vetësi* për *vetmi* etj.). Variacioni gramatikor nuk mund të jetë i pranueshëm për arsye gjuhësore-komunikuese. Njëfarë variacioni fonologjik në fjalë të veçanta (tipi *shtatzënë – shtatzanë*, *burrëri / burrëni*) mund të jetë i pranueshëm. Variacioni ndërgjuhësor është i pranueshëm. Prandaj shprehjet ekzocentrike (njësitë frazeologjike, fjalët e urta e proverbat) nuk mund të përkthehen. Ato gjenden³. (Në parantezë: Kjo do të thotë se u detyrohemi fjalorëve - njëgjuhësh dhe dygjuhësh, si tubues të dijes leksikore dhe të kodifikimit të kësaj dijeje)⁴.

³ Krahaso, p.sh., në shqip e në anglisht: *ka lindur me këmishë dikush* dhe *be born with a silver spoon*; *varret nuk flasin* dhe *dead men tell no tales*; *paraja e bardhë për ditë të zezë* dhe *save (keep) / something for a rainy day*; *i bëj sytë katër* dhe *have eyes in the back of one's head*; *i hedh hi (pluhur) syve / dikujt* dhe *pull the wool over / somebody's eyes*; *(jam) i zënë (me punë) deri në fyt (grykë)* dhe *(be) up to one's eyes / in something*; *ka qimen e ujkut / dikush* dhe *be a badluck Charley*; *ha bukën e përmbys kupën* dhe *bite the hand that feeds you*; *di ta rrjepë patën / dikush* dhe *know which side one's bread is buttered*; *më shkon zemra te thembra* dhe *have one's heart in one's mouth*; *rrahe vëcin, s'të vret kau* dhe *spare the rod and spoil the child*.

⁴ Një shembull i shkëlqyer i këtyre gjetjeve në leksikografinë tonë dygjuhëshe është *Fjalor frazeologjik rusisht-shqip* i Eshref Ymerit, Tiranë, 2015. Fjalori ka 25 160 njësi frazeologjike, fjalët të urta e proverba ruse. Për të gjitha ka barasvlerës të gjetur në shqip. Nuk ka përkthim të fjalëpërfjalshëm. Nuk ka translacionizëm. Shih, p.sh., *perebivatsja s hleba na kvas* mbahet me bishta preshi, rron me një shoshë lakra; *risk – bllagorodnoje djello* fati është me guximtarin; *sjerdce krovju oblillos* i pikoi në zemër; *sjerdce nojet* i sëmbon në zemër. Në shumë e shumë barasvlerës në shqip, autori rreshton edhe sinonime. Gjithashtu, të kërkuara e të gjetura. Shih, p.sh., *vjazat / svjazat v uzllëi* ia bëri rricë, ia futi të dyja këmbët në një këpucë, e bëri të kërcejë valle në tepsi, ia shtrëngoi dizgjinët (rripat), ia shtrëngoi lakun, e futi në shtrungë, ia bëri tetë me dy; *llomat gorb / llomat gorbushku* më këputet kurrizi, më bie bretku, më këputen brinjët, më hollohen kikëzmat, më bien thonjtë, më del shkumë nga goja, bëhem për lesë (për vig), më del shpirti.

Nuk ka ndodhur kështu me *Oxford Albanian-English Dictionary* të Leonard Njumarkut, botuar në Oxford më 1998. Aty ka thuar vetëm përkthime (madje, edhe të fjalëpërfjalshme) të njësive frazeologjike, të fjalëve të urta e të proverbove. Gjetjet janë shumë të pakta. Shih, p.sh., *thur gardhin e hap shtegun* working without plan; *thesi bosh s'qëndron më këmbë* a person can't go without eating, *e lë me gojë hapur* to surprise, to amaze; *s'ka zemër* be merciless. Siç dihet, edhe te fjalët e përbëra pronësore ka variacion ndërgjuhësor në punë të motivimit të tyre e ai duhet të tejduket në një fjalor dygjuhësh. Në Fjalorin e L. Njumarkut, kompozitat *gojëbuall*, *gojëçorap*, *gojëkamare*, *gojëlopë*, *gojëshpellë* përkthehen të gjitha me *large-mouthed* (= gojëmadh). Ky është nocioni. Por nuk është ky barasvlerësi. Ka humbur, më e pakta,

4. Që ta shpjegosh një fjalë si njësi të leksikut, duhet të zbulosh përmbajtjen e saj kuptimore dhe **karakteristikat stilistikore për çdo kuptim**. Këtë detyrë e kryen fjalori shpjegues. Por kjo është vetëm gjysma e punës. Duhet të përcaktosh edhe vendin e çdo *fjale* në sistemin leksikor të gjuhës e në radhë të parë, vendin e fjalëve më të afërta për nga kuptimi (sinonimet). Mirëpo nuk është e lehtë ta përcaktosh se kur dy fjalë janë sinonime. Edhe fjalët më sinonime kanë dallime. Përveç dysorëve (dubleteve), nuk mund të ketë sinonime të plota, identike (në kuptim e në përdorim) e nuk mund t'i përdorësh arbitrarisht njërin për tjetrin e të presësh të ruhet kuptimi. Dallimet janë edhe konotative e stilistike, edhe ligjërimore e funksionale. Edhe shkallëzore e hierarkike (krahaso *i keq* dhe *i tmerrshëm*). Sidoqoftë, ka një rrugë për t'i përdalluar sinonimet. Është zëvendësimi në të njëjtën hapësirë leksiko-semantike – zëvendësimi kontekstual: Nëse një njësi sinonimike mund të zëvendësohet me një tjetër njësi sinonimike, pa e prekur përmbajtjen e kontekstit ose strukturën leksiko-semantike, të dyja janë sinonime. Ndryshe, nuk janë. Kjo provë bëhet nga leksikografët edhe për të pohuar se dy fjalë janë sinonime, edhe për ta mohuar qenien sinonime. Atëherë, gjithsesi, sinonimia, si nocion semantik, na çon te fjala – te fjala e përzgjedhur në një tekst a kontekst të caktuar. E, sigurisht, edhe te shumëkuptimshmëria e *fjalës*, te polisemia e gjuhës.

5. **Fjala** është *njësi e mëvetësishme e fjalësis*, por në *bashkëlidhje* me fjalë të tjera të leksikut. Bashkëlidhja e fjalëve është një nga teknikat themelore shpjeguese në fjalorë. Është fjala për ilustrimin e glosës me shembuj përdorimi.⁵ Te fjala pa fjalën, vështirë se mund ta përcaktojmë kuptimin. Te fjala me fjalën, mundet. Madje, ekzistenca objektive e një fjale mund të provohet nga fakti se mund ta marrësh nga ky kontekst e ta futësh në një tjetër kontekst (tipi *dorë e majtë / dorë e djathtë*). Dhe jo vetëm ekzistenca objektive e fjalës. Me krahasimin e bashkëlidhjeve të zakonshme në ligjërimin e folur ose të shkruar leksikografi sheh e përdallon edhe kuptimet e ndryshme të fjalës së shumëkuptimshme. Me intuitën e tij, këtë e bën edhe folësi i zakonshëm dhe korrigjon keqkuptimet që mund të vijnë nga fjalët e shumëkuptimshme dhe i saktëson ato duke e vënë fjalën në shoqërinë e saj. Por, bashkëlidhjet e fjalëve përcaktojnë jo vetëm kuptimin e një fjale. Ato kanë edhe vlerë denotative (krahaso *kopsht fëmijësh, të kuq buzësh, Udha e Qumështit, lule dhensh, lule peshku, arra e fytit, flutura e rregullatorit* (në teknikë), *bar shpretke, bar blete,*

përmbajtja stilistike e shprehëse – emocionale. Kështu ka ndodhur edhe me kompozita të tjera pronësore të shqipes.

Nëse nuk pasqyrohet variacioni ndër-gjuhësor gjuhë burimore – gjuhë përkthimore, ka përkthim, por jo barasvlerësi.

⁵ Shih një punim tonin, *Çështje të sintagmatikës në fjalorë të shqipes*, në “Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005, f. 158-168.

gjethe delli etj.). Prandaj profesor Kostallari e përcaktonte në *Parimet* e tij lidhjen e fjalëve (sipas metagjuhës së profesorit – thëniet) si një ndër tri elementet për çdo artikull të Fjalorit⁶. Dhe, nëse do të bëhej një recension krahasues për të kërkuar meritat relative të fjalorëve shpjegues kombëtarë të gjuhës shqipe – madje, jo vetëm të gjuhës shqipe, Fjalorit të 1980-ës do t'i jepnim vendin e parë në punë të bashkëlidhjeve ilustruese ose të thënieve⁷. Bashkëlidhja e gjerë, por objektive e tipike e fjalëve në një fjalor të përgjithshëm është koncept i madh i kulturës leksikore⁸. Teorikisht, bashkëlidhja e fjalëve pasqyron lidhjet valencore të fjalëve. Ajo është jo vetëm koncept gjuhësor e sidomos, leksikologjik e leksikografik, por edhe koncept metodik - në fjalorët dygjuhësh (shqip – gjuhë e huaj), në fjalorët shkollorë etj. Bashkëlidhja e fjalëve është edhe një ndër parimet e zgjedhjes së minimumit leksikor. Në praktikën mësimore, bashkëlidhja e fjalëve është mësues i heshtur. Një studim krahasimtar me gjuhë të afërta ose edhe të paafërta tipologjikisht, do të na jepte mundësi të krijonim edhe universale semantike-ligjërimore.

6. *Fjala* në fjalor nuk mund të quhet e mirëqenë pa normën letrare. Prandaj kritika leksikografike përqendrohet fort te karakteri normativ i një fjalori. Është e vërtetë se vetë koncepti *sistem gjuhësor* tregon shkallë standardizimi. Kjo do të thotë që edhe gjuha e zakonshme tregon tendencë për standardizim, domethënë, edhe ajo ka rregulla për kombinimin njësi leksikore (fjalë) / kuptim. Po të mos kishte rregulla e qëndrueshmëri në kombinimin e njësisve leksikore, nuk do të ishim në gjendje të komunikonim me njëri-tjetrin. Po të ndryshonte shumë raporti njësi / kuptim⁹, komunikimi do të ishte i pamundur. Por norma letrare është një koncept shumë më i ngritur¹⁰. Ajo është

⁶ Shih: A. Kostallari, *Parimet për hartimin e "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe"*, në *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1972, f. 50. (Më tej: *Parimet*).

⁷ Argument për këtë është çdo glosë. (Shih, p.sh., glosën **fjalë** / *gjuh.* Janë 30 shembuj përdorimi, që na e *zërthejnë* gjuhësisht atë). Fjalori ka mesatarisht mbi pesë thënie për çdo kuptim, domethënë, gjithsej, mbi 900.000 thënie. Në Fjalor shembujt ilustrues (thëniet) nuk janë sajuar; ata janë gjetur. (Pra, edhe shembujt për fjalët popullore krahinore me vlerë letrare potenciale). Ndryshe, do të ishin të pabesueshëm. Një punë aq kërkuese për leksikografët. Por me rezultat aq bindës për përdoruesit.

⁸ Kjo bashkëlidhje e ka bërë *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980) një Fjalor ortologjik, drejtligjërimor.

⁹ Siç dihet, në kuptimin e fjalëve ka një element arbitrar: Fjala nuk ka në mënyrë inhereente kuptim të caktuar, specifik. Në thelb, fjala ka atë kuptim (a çdo kuptim) që ruan e zgjedh bashkësia ligjërimore. Por ky kuptim nuk është e nuk duhet të jetë aq arbitrar, sa të mos e njohim në një çast të caktuar ligjërimor.

¹⁰ Shih edhe: M. Samara, *Rreth normës leksikore dhe kodifikimit të saj në fjalorët shpjegues të shqipes*, në "Leksikografia shqipe - trashëgimi dhe perspektivë", Tiranë, 2005, f. 51-55.

tërësia e rregullave që përcaktojnë përdorimin e mjeteve të gjuhës letrare në mënyrë të njëjlojtë për të gjithë pjesëtarët e një kombi, përdorimi i mjeteve gjuhësore që është ngulitur e është pranuar nga të gjithë pjesëtarët e një kombi, si në ligjërimin e folur, ashtu edhe në atë të shkruar. Nënvizojmë: *Për të gjithë pjesëtarët e një kombi*.

Norma, siç dihet, është kategori historike. Ajo nuk ka vetëm bazë territoriale, por edhe bazë sociale. Ajo ngulit format *më të qëndrueshme* të shprehjes, që janë karakteristike në një etapë të caktuar të zhvillimit të saj. Kësisoj, norma ruan identitetin e ligjërimin të bashkësisë, duke e rritur kohezionin e saj. Në këtë kuptim: Po të vepronte norma dialektore-krahinore si variant funksional i gjuhës sonë, do të binte skema “gjuhë-normë-ligjërim” dhe do të vendosej skema “gjuhë-ligjërim-normë”. Me pasojat krejt negative. Prandaj profesor Kostallari thotë: “Ata që e përpunojnë gjuhën e popullit, nuk e ulin gjuhën letrare në nivelin e gjuhës së masave më të prapambetura, por e ngrenë gjuhën e masave në nivelin e gjuhës letrare të përpunuar, duke mos e shpërndarë asnjëherë nga gjuha e popullit ..., duke e pastruar atë nga çrregullimet që sjellin format dialektore, si në fjalor, ashtu edhe në gramatikë”¹¹.

Po cili është roli kodifikues i fjalorëve për ruajtjen dhe zhvillimin e normës? Fjalorët pasqyrojnë përdorimin më të mirë të gjuhës (kemi parasysh konceptin për normën). Ky vlerësim është shumë i rëndësishëm për të kuptuar zhvillimin e gjuhës standarde dhe natyrën e funksionimit të fjalorit për standardizimin në tërësi.

Siç dihet, një ndër veçoritë e gjuhës standarde janë ato strukturore. Ndikimi i fjalorëve është më i dukshëm pikërisht te këto veçori – me korrektësinë gramatikore, me informacionin për fushën e përdorimit¹² dhe për statusin stilistik të *fjalëve*, me variacionin leksikor, social dhe gjeografik etj. Kësisoj, fjalori ndikon në qëndrueshmërinë e standardit. Fjalorët ndikojnë duke nxitur zbatimin e atyre normave standarde, që janë vendosur sot dhe duke zbuluar mundësi të reja për përforcimin e tyre. Profesor Kostallari thotë: “Duke përhapur dhe *përforcuar* (nënvizimi im -H.Sh.) normën letrare..., ai (Fjalori-H.Sh.) sanksionon rrugët ku do të ecë zhvillimi i leksikut të gjuhës sonë edhe në të ardhmen”. Nëse fut në fjalor (siç ka ndodhur në Fjalorin e gjuhës shqipe, 1954) “fjalë të tilla, si *adet, sebeb, sall ...* etj., do të thotë se mbështetet përdorimi i tyre në gjuhën e sotme shqipe”. Nëse nuk fut në fjalor “fjalë të tilla, si *aeroplanmbajtëse, bashkëbisedim ...* etj.”, siç ka ndodhur në Fjalorin e gjuhës shqipe, 1954, “do të thotë se (Fjalori-H.Sh.) bëhet një pengesë jo vetëm

¹¹ *Parimet*, f. 94.

¹² Çdo fushë veprimtarie ka nevojat e veta të komunikimit, por njëherësh, kërkon një sistem të njësuar. Prandaj gjuha standarde i plotëson një për një të gjitha nevojat që ka ligjërimi i ndërlikuar i shoqërisë.

për përhapjen e këtyre fjalëve, por edhe të fjalëve të tjera që janë të një tipi me to nga pikëpamja strukturore-semantike, si edhe të vargjeve leksikore, që lidhen me to¹³.

Çdo bashkësi gjuhësore ka kohezionin e vet të brendshëm. Fjalorët pasqyrojnë, siç u tha, tipat e modeleve gjuhësore standarde të pranuar nga bashkësia, duke e shtuar këtë kohezion. Atëherë, përderisa bashkësia ligjërimore ka kohezionin e saj, *i suksesshëm është ai fjalor që e shton këtë kohezion, duke i pasqyruar tipat e modeleve gjuhësore standarde*, që janë pranuar nga ajo. Këtë bën edhe Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, 1980. Ai e jep leksikon e shqipes së sotme si një sistem të strukturuar e të modelizuar me zgjedhjen e *fjalësit*¹⁴, drejtshkrimin e fjalëve, karakterizimin gramatikor, përmbajtjen kuptimore, lidhjet kuptimore (sinonime, antonime etj.), thëniet ilustruese përdorimore etj. Të gjitha këto bëhen edhe me dallime shtypshkrimore fare të imëta. Për leksikografin, por edhe për përdoruesin e Fjalorit ato janë me vlerë informuese. Përmendëm pak më lart veçoritë strukturore të gjuhës standarde, sepse ato janë vendi ku ndikimi i fjalorëve është më i dukshëm. Por, përse është më i dukshëm? Është më i dukshëm sepse kodifikimi (glosari i përzgjedhur, shpjegimet leksikografike, sistematizimi i fushave leksikore etj.) jepet në fjalor si dije, si “informacion”. Brenda kësaj dijeje, Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, 1980, jep informacion për përdorimin e *leksikut* jo vetëm gramatikisht, por edhe stilistikisht: për variacionet leksikore-sociale, kohësore, gjeografike / me metodat dhe teknikat leksikografike – shënimet ligjërimore e stilistike. Pa karakteristikën stilistike, *fjala* në fjalor mbetet si një njësi e vdekur, e shkëputur nga përdorimi i saj i gjallë. Pa karakteristikën stilistike të fjalëve nuk mund të ketë fjalor normativ në kuptimin e vërtetë. Fjalori ka stabilizuar formën e gjuhës. Ai ka përshtatur përdorimin e gjuhës letrare kombëtare. Ai u ka lënë vendin e duhur edhe fjalëve të reja, edhe fjalëve me burim popullor me vlerë letrare potenciale. Kësisoj, ai ka krijuar lehtësi për standardin kombëtar. Ligjërimi i shoqërisë, siç u cek pak më lart, ka kohezionin e vet. Gjuha standarde e shton dhe e forcon këtë kohezion. Edhe fjalori normativ. Atëherë, Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, 1980, me kryeredaktor profesor Kostallarin është i mirë e i suksesshëm sepse e ka ruajtur identitetin e ligjërimin të bashkësisë shqiptare, e ka pasqyruar këtë kohezion dhe e ka shtuar këtë kohezion.

Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980) është vepër e shkëlqyer – unike në historinë e leksikografisë shqipe: me një teori të veten, të përpunuar fort në punë të *fjalësit* e të *fjalës* si njësi e tij, në punë të ndarjes së qëndrueshme kuptimore, të zgjidhjeve të sakta gramatikore – mjaft prej tyre, për herë të parë në këtë Fjalor, të thënieve të mjaftueshme për çdo kuptim – aq të mjaftueshme,

¹³ Për këto citime shih: *Parimet*, f. 83.

¹⁴ Përkundër dëshirës së hartuesve, shpesh, vëllimi i një fjalori kufizohet nga prerja e tij.

sa për një fjalor të madh drejtligjërimit të shqipes. Publiku pret fjalorë të tjerë shpjegues (p.sh., Fjalorin e Madh Shpjegues të Gjuhës Shqipe), të cilët, edhe pse sinkronikë, janë edhe historia e përdorimit të *fjalës*. E, çdo fjalor tjetër i tanishëm a i mëpasëm i detyrohet *Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe* (1980). Pa këtë Fjalor, për çdo leksikograf do të ishte, më e pakta, sikur një kameraman të mos e kishte trekëmbëshin, kur duhet ta ketë domosdo.

SUMMARY

THE WORD AS AN INDEPENDENT UNIT OF A DICTIONARY

In this article I have attempted to account for some concepts as to the word as an independent unit of a dictionary. Six concepts are mentioned:

1. The richness of the lexicon of the Albanian language and its *dictionary* cannot be considered only the general number of its entries, but also the number of their meanings and their sense shades explained. Moreover, this is the concept on the lexical unit.

2. Word formation is one of the most important linguistic mechanisms which ensures the multiplicity and even, the infinity of the lexicon. But it is a dictionary which shows us this multiplicity and the impossibility for an infinity.

3. There is an intralingual variation. There is especially an interlingual variation. Behind these variations stand the *words*. Lexical intralingual variation is accepted for linguistic and historical reasons, already known. Phonological intralingual variation in certain words is accepted, too. Grammatical variation cannot be accepted for linguistic – communicative reasons. Interlingual variation is accepted. That's why exocentric expressions (phraseological units, wise words and proverbs) should be reflected in a dictionary, and they cannot be translated from a source language to a target language. They are to be found.

4. In order to explain a word as a unit of the lexicon, its semantic and stylistic contents must be revealed. And it is the explanatory dictionary fulfilling this task. But it is half the work done. It is needed to determine the place of every entry in the lexical system of the language and first and foremost, the place of the synonyms. And the discrimination of synonyms is becoming a standard in modern dictionaries.

5. A word is an independent unit of a dictionary, but in combination with other words. Thus, considering a dictionary means not only how many words and senses are entered, but also how comprehensible are the examples given. The illustrative word-combinations (collocations) are designed to elucidate the senses of a word and its shades of meaning in an ordinary context. (Outside a word-combination it is difficult to distinguish the senses of a word). They

support definitions and explanations. They discriminate synonyms or groups of synonyms. They represent the language as it is used.

6. A word cannot be considered appropriate in a dictionary without its literary standard. That's why the lexicographic critics is much focused at the normative character of a dictionary. The standard preserves the identity of the speech of the community by increasing its cohesion for it establishes the most stable forms of the speech, characteristic for a definite stage of its development. And the scheme of things is language – standard – speech. In the article is explained: What is the codifying role of the dictionaries in preserving g and developing the standard.

